



REPUBLIKA E ALBANIAS  
MINISTRIA E BRENDSHME

## SIGURIA DHE PUNËT E BRENDSHME

» Mars 2022



### ÇUÇI PRET ZV. PRESIDENTIN E KE, JOSEPH BORRELL

Ministri i Brendshëm Bledi Çuçi shprehu gatishmërinë për pritjen e migrantëve ukrainas gjatë takimit me Zv. presidentin e KE-së, Josep Borrell. Në takim u diskutua edhe për situatën aktuale të luftës në Ukrainë, sanksionet ndaj Rusisë dhe sigurinë kibernetike. Ministri siguroi zyrtarin e lartë, se të gjitha politikat e sigurisë të Shqipërisë do të vijojnë në përputhje me politikat e BE-së. Në takim u vlerësua bashkëpunimi me Shqipërinë në fushat më të rëndësishme që lidhen me politikën e jashtme dhe sigurinë europiane.

BULETINI MUJOR I MB

WWW.MB.GOV.AL

01



### KONFLIKTI - SHTETAS UKRAINAS AKOMODOHEN NË VENDIN TONË

Një numër shtetasish nga Ukraina janë strehuar në Shqipëri, që prej nisjes së konfliktit me Rusinë. Ukrainasit mund të hyjnë në territorin shqiptar pa vizë dhe të qëndrojnë pa leje qëndrimi për një periudhë 1-vjeçare. Këto masa i konfirmoi ministri i Brendshëm Bledi Çuçi në takim me ambasadorin e Ukrainës Volodymyr Shkurov. Ministri ofroi mbështetje për të gjithë ukrainasit e ardhur apo që mund të vijnë në të ardhmen dhe informoi mbi masat lehtësuese që janë marrë për hyrjen dhe qëndrimin e tyre në Shqipëri.

BULETINI MUJOR I MB

WWW.MB.GOV.AL

02



### PRITET NËNSHKRIMI I TRE MARRËVESHJEVE TË REJA ME GREQINË

Tre marrëveshje të reja pritet të nënshkruhen me Greqinë. Kjo u konfirmua pas takimit të zv. ministrit Andi Mahila me homologun grek Eleftherios Oikonomou. Marrëveshjet kanë të bëjnë me parandalimin e incidenteve kufitare, mirëmbajtjen e shenjave kufitare dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit. Në takim u diskutua edhe për nënshkrimin i një memorandumi bashkëpunimi ndërmjet dy akademive policore, si dhe mbi nevojën e nënshkrimit të protokollit të riparimit me Greqinë.

BULETINI MUJOR I MB

WWW.MB.GOV.AL

03



### RRITJE E FORCËS GODITËSE PËR KRIMET KUFITARE

Rritja e forcës goditëse ndaj krimeve kufitare dhe intensifikimi i shkëmbimit të informacionit për kapjen e personave që tentojnë t'i shpangjen drejtësisë, ishte në fokus të takimit të zv. ministrit Julian Hodaj me anëtarët e Komisionit Parlamentar të sigurisë të Kosovës dhe Shqipërisë. Në takim i u vlerësua bashkëpunimi policor midis dy vendeve. U vu në dukje edhe ndihma që jep Policia Shqiptare për atë të Kosovës në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare.

BULETINI MUJOR I MB

WWW.MB.GOV.AL

04



REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
MINISTRIA E BRENDSHME

## SIGURIA DHE PUNËT E BRENDSHME

» Mars 2022



### INTEGRIMI - PLATFORMË PARTNERITETI ME SHOQËRINË CIVILE

Krijimi i Platformës së Partneritetit dhe bashkëpunimi i ngushtë me shoqërinë civile do ta avancojë edhe më tej procesin përgatitor në rrugëtimin e Shqipërisë drejt BE-së.

Zv.ministri i Brendshëm Besfort Lamallari dhe kryenegociatori për integrimin Zef Mazi mbledhën grupin ndërinstucional të punës në kuadër të hapjes së negociatave dhe detyrimeve që rrjedhin prej tyre për Kapitullin 24. Shoqëria civile ka një rol kyç, në ekspertizë por jo vetëm, gjatë procesit përgatitor të Shqipërisë drejt BE-së, përkatësisht hapjes së negociatave dhe detyrimeve që rrjedhin për Kapitullin 24.

BULETINI MUJOR I MB

WWW.MB.GOV.AL

05



### RENEA, E 10-ta MES 41 FORCAVE SPECIALE NGA E GJITHË BOTA

Reparti Special RENEA, elita e Policisë së Shtetit, u rendit e 10-ta mes 41 forcave speciale nga e gjithë bota në garën ndërkombëtare të forcave speciale "SEAT Challenge", që u zhvillua në Dubai. RENEA mori pjesë për herë të parë. Sipas komentatorëve shpirti i garës, kompaktësia në grup, përgatitja fizike, dhe disiplina karakterizuan grupin RENEA, ku në garën e fundit, "Kalimi i Brezit të Kalitjes", konsideruar ndër më të vështirat, tregoi rezistencë dhe forcë të lartë fizike në finalizimin me sukses të sfidës.

BULETINI MUJOR I MB

WWW.MB.GOV.AL

06



### ZGJEDHJET E PJESSHME LOKALE – ASNJË PROBLEM ME LISTAT E RENDIN

Në 6 mars janë zhvilluar zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Lushnje, Rrogozhinë. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile gjeneroi listat e zgjedhësve me të drejtën e votës. Policia e Shtetit u angazhua në 6 bashkitë ku u mbajt procesi elektoral dhe nuk u evidentua asnjë problem në fushën e rendit. Roli i Policisë u vlerësua përmes një letre falënderimi edhe nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

BULETINI MUJOR I MB

WWW.MB.GOV.AL

07